

V E N D I M
Nr.110, datë 13.3.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.160, DATË
9.7.1975 “ MBI NORMAT E FURNIZIMIT ME USHQIM TË USHTRISË DHE TË ORGANEVE
E REPARTEVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të vendimit të Këshillit të Mbrojtjes nr.2, datë 16.10.1998 “Për krijimin e Batalionit Special të Brigadave “Komando””, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.160, datë 9.7.1975 në pasqyrën 1, pika 6, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

-“Kuatrot ushtarake të Batalionit Special të Brigadave “Komando” për kohën që janë grup i gatshëm në stërvitje të zgjatura, fushime dhe gjatë kryerjes së detyrave me efektivin e tyre jashtë rajonit të dislokimit”.

2.Efektet ekonomike nga ndryshimet e mësipërme, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, i miratuar për vitin 1999.

3.Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë aktet nënligjore në bazë dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko